



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 54

Qershor

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.765, datë 16.11.2006	Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2007, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të ujërave të Ndotura	3
Vendim i KM nr.782, datë 16.11.2006	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit Kombëtar të Veprimit 2007-2013	4
Vendim i KM nr.795, datë 27.11.2006	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e veprimtarive të Crans Montana Forum.....	4
Vendim i KM nr.796, datë 27.11.2006	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin, në Itali, të z.Bashkim Gazidede	5
Vendim i KM nr.797, datë 27.11.2006	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin, në Itali, të znj.Mimoza Dhëmbi	5
Vendim i KM nr.799, datë 8.12.2006	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe UNESCO-s, për projektin “Restaurimi i qendrës historike të qytetit të Gjirokastrës”, financuar nga UNESCO-ja	6
Vendim i KM nr.804, datë 6.12.2006	Për lirin dhe caktimin e administratorëve të shoqërive huamarrëse, në administrim	6
Vendim i KM nr.811, datë 13.12.2006	Për shlyerjen e disa detyrimeve të ndërsjella të ndërmarrjeve publike.....	7

Vendim i KM nr.820, datë 6.12.2006	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i transferohen në pronësi ose në përdorim komunës Cukalat që qarkut të Beratit.....	7
Vendim i KM nr.824, datë 6.12.2006	Për miratimin e institucioneve të autorizuara për verifikimin, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore, si dhe të formularit të vetëdeklarimit.....	8
Vendim i KM nr.826, datë 13.12.2006	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj.Hamide Xhaja	11
Vendim i KM nr.827, datë 13.12.2006	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Miho Gjini....	11
Vendim i KM nr.828, datë 13.12.2006	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Xhemal Meçi.	11
Vendim i KM nr.829, datë 13.12.2006	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Pano Taçi	12
Vendim i KM nr.832, datë 13.12.2006	Për dhënie ndihme financiare familjeve të ish-oficerëve të Gardës së Republikës, Vangjel Kiço Çondi, Qemal Bilal Koni, Demush Hajdar Hebaj, dhe të ish-mjekut të QSU-së, “Nënë Tereza”, Tiranë, Sandër Preng Baloj, për rast vdekjeje gjatë kryerjes së detyrës	12
Vendim i KM nr.836, datë 13.12.2006	Për miratimin e protokollit “Për disa ndryshime në marrëveshjen “Për bashkëpunimin financiar, 1996, në projektin “Planifikimi familjar III”, të nënshkruar, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, në datë 16.12.2004”.....	13
Vendim i KM nr.838, datë 13.12.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës”, të ndryshuar	14
Vendim i KM nr.843, datë 15.12.2006	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj.Anjeza Derani (Duli).....	14
Vendim i KM nr.844, datë 15.12.2006	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Urani Kondo (Çeliku).....	15
Vendim i KM nr.846, datë 15.12.2006	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Kadri Musaj...	15
Vendim i KM nr.848, datë 15.12.2006	Për miratimin e çmimit të shitjes së Buletinit të Njoftimeve Publike.....	15
Vendim i KM nr.849, datë 13.12.2006	Për një shpërblim të veçantë të punonjësve të Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe Provimeve	16
Vendim i KM nr.855, datë 13.12.2006	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i infrastrukturës portuale në portin e Durrësit	16

Vendim i KM nr.865, datë 20.12.2006	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Perikli Çuli....	18
Vendim i KM nr.866, datë 20.12.2006	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror Z.Tajar Kokalari	18
Vendim i KM nr.877, datë 27.12.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.495, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve, të personave dhe sasisë së nevojshme të karburantit për përdorim nga anijet e peshkimit”, të ndryshuar.....	19

VENDIM
Nr.765, datë 16.11.2006

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2007, TË ENTIT
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT DHE
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 11 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2007, për Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për shumën 20690000 (njëzet milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Enti Rregullator i Ujit

Pasqyra nr.1

PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2007

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Në 000/lekë
1	Shpenzime për paga	12 023
2	Sigurime shoqërore	2 602
3	Shërbime e furnitura	5 065
4	Investime	1000
	Totali	20 690

VENDIM
Nr.782, datë 16.11.2006

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË RINISË DHE PLANIT
KOMBËTAR TË VEPRIMIT 2007-2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit Kombëtar të Veprimit, 2007-2013, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.795, datë 27.11.2006

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE
PËR ORGANIZIMIN E VEPRIMTARIVE TË CRANS MONTANA FORUM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 32 000 000 (tridhjetë e dy milionë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme, për organizimin e veprimtarive të Crans Montana Forum, që do të zhvillohen jashtë shtetit dhe në Shqipëri, në maj të vitit 2007, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe këtij Forumi.

2. Ky fond të përballohet nga pjesa e papërdorur e fondeve, të dhëna me vendimin nr.67, datë 9.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përzgjedhjen e shoqërisë, që do të bëjë kontrollin e procedurave dhe të ligjshmërisë së kontratës për privatizimin e “Albtelecom”, sh.a.”.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.796, datë 27.11.2006

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN,
NË ITALI, TË Z.BASHKIM GAZIDEDE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 8 e 12, të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, në programin “Administrim, planifikim, menaxhim”, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 4000000 (katër milionë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin, në Itali, të z.Bashkim Gazidede.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Paga të kryhet pas paraqitjes së faturave përkatëse.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.797, datë 27.11.2006

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN,
NË ITALI, TË ZNJ.MIMOZA DHËMBI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 8 e 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për buxhetin e shtetit, të vitit 2006” me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, në programin, “Administrim, planifikim, menaxhim”, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 4400000 (katër milionë e katërqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin, në Itali, të zj.Mimoza Dhëmbi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Paga të kryhet pas paraqitjes së faturave përkatëse.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.799, datë 8.12.2006

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE UNESCO-S, PËR PROJEKTIN “RESTAURIMI I QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË GJIROKASTRËS”, FINANCUAR NGA UNESCO-JA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 17 të ligjit nr.8371, datë 13.5.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe UNESCO-s, për projektin “Restaurimi i qendrës historike të qytetit të Gjirokastrës”, financuar nga UNESCO-ja, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.804, datë 6.12.2006

PËR LIRIMIN DHE CAKTIMIN E ADMINISTRATORËVE TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE, NË ADMINISTRIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7/2 e 7/8 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Illir Laku lirohet nga detyra e administratorit të shoqërisë huamarrëse, në administrim, “Gjallica”.

2. Z.Flamur Laze lirohet nga detyra e administratorit të shoqërive huamarrëse, në administrim, “Nahlel”, “Global Foods”, “Fabiona”, “Univers” e “Beno” dhe të fondacioneve “Populli” dhe “Xhaferri”.

3. Z.Ymer Liksala, administrator i shoqërive huamarrëse, në administrim, “Kamberi”&Co dhe “M.Leka”, caktohet gjithashtu administrator edhe në shoqëritë “Nahlel”, “Global Foodes”, “Fabiona”, “Univers”, e “Beno” dhe në fondacionet “Populli” dhe “Xhaferri”.

4. Ngarkohen Grupi Mbikëqyrës dhe administratorët e shoqërive huamarrëse, në administrim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.811, datë 13.12.2006

PËR SHLYERJEN E DISA DETYRIMEVE TË NDËRSJELLA TË NDËRMARRJEVE
PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet shuma prej 158 000 000 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milionë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve dhe minierave, në likuidim dhe konservim, ndaj KESH, sh.a.

2. Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet shuma prej 1 070 500 000 (një miliard e shtatëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të ndërmarrjeve të ujësjellësve ndaj KESH, sh.a-së, si dhe shuma prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të ujësjellësve ndaj ISSH-së.

3. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet shuma prej 71 500 000 (shtatëdhjetë e një milionë e pesëqind mijë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të bordeve të kullimit të QTTTB-së, Lushnjë, ndaj KESH, sh.a-së.

4. Fondi prej 1 400 000 000 (një miliard e katërqind milionë) lekësh të përballohet nga fondi i kontigjencës, i planifikuar për vitin 2006.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Bujqësisë dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe ISSH-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.820, datë 6.12.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË I TRASFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, KOMUNËS
CUKALAT, QË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i transferohen, në pronësi ose në përdorim, komunës Cukalat të qarkut të Beratit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraparaqe, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Cukalat të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.2, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Cukalat”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Cukalat për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Cukalat

Lidhja nr.1

Numrat rendor të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
6-8	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
9-23	Infrastrukturë (troje e lirë)	Në përdorim
41;42	Administratë	Në pronësi
24-40	Shërbim funeral	Në pronësi
43	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
71-484	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
52;59,62,66;69;70	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi
50;51;53;54;55;56;57;58;.. 60;61;63;64;65'67;68	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

VENDIM
Nr.824, datë 6.12.2006

PËR MIRATIMIN E INSTITUCIONEVE TË AUTORIZUARA PËR VERIFIKIMIN, NË MËNYRË ELEKTRONIKE, TË GJENDJES GJYQËSORE, SI DHE TË FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 8, e 11 të ligjit nr.9614, datë 21.9.2006 “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Institucionet, që autorizohen për verifikim, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore, janë:

1. Zyra e Presidentit të Republikës;
2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë;
3. Prokuroria e Përgjithshme;
4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;

5. Ministria e Drejtësisë;
6. Ministria e Brendshme;
7. Ministria e Mbrojtjes;
8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
9. Ministria e Punëve të Jashtme;
10. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabara;
11. Ministria e Financave;
12. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
13. Shërbimi Informativ i Shtetit;
14. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
15. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
16. Interpoli;
17. Garda e Republikës;
18. Departamenti i Administratës Publike;
19. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
20. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
21. Përfaqësitë diplomatike, me autorizim të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
22. Banka e Shqipërisë;
23. Përfaqësia e Bashkimit Europian në Republikën e Shqipërisë;
24. Përfaqësia e Këshilit të Europës në Republikën e Shqipërisë;
25. Përfaqësia e NATO-s në Republikën e Shqipërisë.

II. Miratimin e formularit të vetëdeklarimi, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe subjektet e tjera, që përcaktuara në këtë vendim, të caktojnë personin përkatës, që do të ketë akses për të përfutur të dhënat e parashikuara në pikën 8 të nenit 2 të ligjit nr.9614, datë 21.9.2006 “Për certifikatat elektronike të gjendjes civile gjyqësore”, brenda një afati prej 10 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

IV. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR VETËDEKLARIMI

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Mbiemri, Emri Atësia/Amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: ☐ *i/e padënuar* ☐ *i/e dënuar*

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

Emër, mbiemër/firmë_____
Emër, mbiemër/firmë / vulë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga _____
Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues_____
Data e nënshkrimit

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme.

VENDIM
Nr.826, datë 13.12.2006

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZNJ. HAMIDE XHAJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Hamide Xhaja, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.12.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.827, datë 13.12.2006

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. MIHO GJINI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Miho Gjini, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.12.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.828, datë 13.12.2006

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. XHEMAL MEÇI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zotit Xhemal Meçi, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.12.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.829, datë 13.12.2006

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. PANO TAÇI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Pano Taçi, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.12.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.832, datë 13.12.2006

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË ISH-OFCERËVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS, VANGJEL KIÇO ÇONDI, QEMAL BILAL KONI, DEMUSH HAJDAR HEBAJ, DHE TË ISH-MJEKUT TË QSU-SË, “NËNË TEREZA”, TIRANË, SANDËR PRENG BALOJ, PËR RAST VDEKJEJE GJATË KRYERJES SË DETYRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “d” të pikës 2 të nenit 39 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare familjeve të z.Vangjel Kiço Çondi, z.Qemal Bilal Koni, z.Demush Hajdar Hebah, ish-oficerë në Gardën e Republikës, dhe të z.Sandër Balloj, ish-mjek në QSU “Nënë Tereza”, Tiranë, në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë secilës, për rast vdekjeje gjatë kryerjes së detyrës.

2. Shuma e përgjithshme prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh të depozitohet në llogarinë likuiduese të Gardës së Republikës, me nr.0101030780, në Raiffeisen Bank dhe dhënia personave përfitues të bëhet me komision, nëpërmjet arkës së Gardës së Republikës.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.836, datë 13.12.2006

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT “PËR DISA NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN
“PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR, 1996, NË PROJEKTIN “PLANIFIKIMI FAMILJAR
III”, TË NËNSHKRUAR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, NË
DATË 16.12.2004”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit “Për disa ndryshime në marrëveshjen “Për bashkëpunimin financiar, 1996, në projektin “Planifikimi familjar III””, të nënshkruar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale Gjermanisë, në datë 16.12.2004”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROTOKOLL
**PËR ZËVENDËSIMIN E FAQEVE TË GABUARA TË MARRËVESHJES SË NËNSHKRUAR
MË DATË 16 DHJETOR 2004 NË TIRANË, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR
BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 1996**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë morën vesh si vijon:

Ballina (faqja e parë), si dhe faqja e tretë e të dy versioneve gjuhësore të origjinalit shqiptar të marrëveshjes së lartpërmendur po zëvendësohen me ballinën (faqe e parë, të bashkëlidhur të korrigjuar dhe me faqen e tretë të bashkëlidhur të korrigjuar të të dy versioneve gjuhësore.

Ballina (faqja e parë), si dhe faqja e tretë e të dy versioneve gjuhësore të origjinalit gjerman të marrëveshjes së lartpërmendur po zëvendësohen me ballinën (faqen e parë) të bashkëlidhur të korrigjuar dhe me faqen e tretë të bashkëlidhur të korrigjuar të të dy versioneve gjuhësore.

Korrigjimet janë të vlefshme *ab initio* (me prapaveprim prej datës së nënshkrimit).

Ky protokoll hyn në fuqi së bashku me këtë marrëveshje.

Bërë në Tiranë më datë 8.11.2006 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst vlerë të barabartë

VENDIM
Nr.838, datë 13.12.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.231, DATË 11.5.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL DHE PERIUdhËN E PROVËS”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 17 e vendimit nr.231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“17. Pikët maksimale të mundshme janë:

- a) 70 pikë në rezultatin e testimit;
- b) 10 pikë për përvojën në punë të kandidatit dhe kualifikimet afatshkurtra;
- c) 12 pikë për diplomën master;
- ç) 8 pikë për aftësitë e veçanta personale;
- d) kandidatët me gradë shkencore “Doktor i shkencave” vlerësohen me pikët maksimale të testimit me gojë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.843, datë 15.12.2006

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR
ZNJ. ANJEZA DERANI (DULI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Anjeza Derani (Duli), në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.12.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.844, datë 15.12.2006

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR
ZNJ. URANI KONDO (ÇELIKU)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Urani Kondo (Çeliku), në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.12.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.846, datë 15.12.2006

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. KADRI MUSAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Kadri Musaj, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.12.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.848, datë 15.12.2006

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË BULETINIT TË NJOFTIMEVE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Çmimi i shitjes së Buletinit të Njoftimeve Publike, që botohet nga Agjencia e Prokurimit Publik, të jetë 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë/copa.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.849, datë 13.12.2006

PËR NJË SHPËRBLIM TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE TË QENDRËS KOMBËTARE ARSIMORE TË VLERËSIMIT DHE PROVIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për buxhetin e shtetit, të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e 12 (dymbëdhjetë) punonjësve të Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe Provimeve, për punën e kryer për realizimin e Maturës Shtetërore, deri në 5 (pesë) paga mujore, në varësi të kontributit të secilit.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga të ardhurat e realizuara për vitin 2006, nga Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe Provimeve.

3. Ngarkohet Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe Provimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.855, datë 13.12.2006

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS PORTUALE NË PORTIN E DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i infrastrukturës portuale në portin e Durrësit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Portual, Durrës.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, të paraqitur në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 7 303 m², tokë truall, e vlerësuar me 3 000 lekë/ m², në shumën e përgjithshme 21 909 000 (njëzet e një milionë e nëntëqind e nëntë mijë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 21 909 000 (njëzet e një milionë e nëntëqind e nëntë mijë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Autoritetit Portual, Durrës.
 5. Shpenzimet procedurale, në shumën 185 500 (njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Autoriteti Portual, Durrës.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda vitit 2006.
 7. Likuidimi i pronarëve nga Autoriteti Portual të bëhet brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Autoriteti Portual, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I
INFRASTRUKTURËS PORTUALE NË PORTIN E DURRËSIT**

Nr.	Emri	Pasuria	Zona kadastrale	Sipërfaqja	Çmimi në lekë për m ²	Vlera në lekë
1	Bashkëpronarët Krisanthi Qirko Spiro Qirko Margarita Qirko Mukades Kapshtica Sanije Kapshtica Viktoria Kraja Nadia Kapshtica Ana Veizi	NR.7/51 7/52	8514	3 703 m ²	3000	11 109 000
2.	Bashkëpronarët Rudolf Lara Kozma Lara Vangjel Lara Veronika Lara Sotireta Lara Dhimitër Lara	NR.6/108	8514	3 600 m ²	3000	10 800 000
	SHUMA			7 303 m²		21 909 000

Vlera totale e shpronësimit është 21 909 000 lekë.

VENDIM
Nr.865, datë 20.12.2006

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. PERIKLI ÇULI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Perikli Çuli, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.12.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.866, datë 20.12.2006

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR
Z. TAJAR KOKALARI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Tajar Kokalari, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.12.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.877, datë 27.12.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.495, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, TË PERSONAVE DHE SASISË SË
NEVOJSHME TË KARBURANTIT PËR PËRDORIM NGA ANIJET E PESHKIMIT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave , Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3/1 e vendimit nr.495, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3/1. Efekti financiar, prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, për 6-mujorin e dytë të vitit 2006, për mbulimin e diferencës ndërmjet çmimit të programuar vjetor të “Armo”, sh.a., dhe çmimit 40 lekë/litri, t’i paguhet kësaj shoqërie nga pakësimi, në të njëjtën shumë, i fondeve buxhetore, të vitit 2006, zëri “Kompensim i energjisë elektrike”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 4.6.2010

Doli nga shtypi më 6.6.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 24 lekë